



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE TË KZAZ-VE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, me shkresat nr. 12629, nr.12629/1, nr.12631 prot., datë 28.06.2019, ka kërkuar:

- lirim të anëtares së KZAZ nr. 40, zj. Olsida Goxhaj dhe emërim të zj. Joana Çako;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 82, z. Sokol Kananaj dhe emërim të zj. Ina Luci;

Me shkresën nr. 12332 prot., datë 26.06.2019, anetar i KZAZ nr. 15, z. Erand Ndoja, emëruar kryesisht nga KQZ për arsye objektive ka dhënë dorëheqjen.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Kurbin.

Nr. 922 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Estri Keci, me vendbanim në Bashkinë Kurbin, arsim juridik, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar anëtar i KZAZ nr.15.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

